



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERVBAL¹

I përmbledhur

Tiranë, më 17.07.2020, ora 13:30

Drejton mbledhjen -

Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës:

Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, të rishpallura nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019:

- Ardita Alsula (Buna)
- Dedë Kasneci
- Klodian Rado
- Shaqir Hasanaj
- Vjosa Bodo
- Besnik Muçi
- Envi Hicka
- Prel Martini
- Vasil Bendo

2. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.

Marrin pjesë:

1. Vitore Tusha

(zv/kryetare)

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

- | | |
|---------------------|------------|
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Ludovik Dodaj | (anëtar) |
| 8. Arjan Qafa | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

- 1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.**

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

- 1. Bledar Dervishaj**, përfaqësues i Presidentit të Republikës dhe zonja **Katrin Treska**, përfaqësuar nga autorizimi nr. 446 prot, datë 29.01.2020.

HAPET MBLEDHJA

Ora 13:30

Vitore Tusha deklaron të hapur mbledhjen e thirrur sipas rendit të ditës që ju është komunikuar të pranishmëve, si dhe verifikon prezencën e anëtarëve, duke vënë në dukje se zonja Erinda Ballanca, për shkak të impenjimeve me detyrën, ka pak vonesë Të pranishëm janë edhe dy përfaqësuesit e Presidentit, zoti Bledar Dervishaj dhe zonja Katrin Treska.

Çështjet e rendit të ditës lidhen me shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese, të rishpallura nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019, për kandidatët:

- **Ardita Alsula (Buna)**
- **Dedë Kasneci**
- **Klodian Rado**
- **Shaqir Hasanaj**
- **Vjosa Bodo**
- **Besnik Muçi**
- **Envi Hicka**
- **Prel Martini**
- **Vasil Bendo**

Dhe vendimmarrjen për lejimin/ndalimin e kandidatëve të mësipërm.

Nuk është përfshirë si pikë e parë e rendit të ditës miratimi procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së shkuar për shkaqe objektive, pasi reduktimi i veprimtarisë së gjykatës së Lartë,

siç është njoftuar, ka sjellë një prani më të kufizuar të punonjësve që ndihmojnë në zbardhjen e tij. Vihet në dukje se në mbledhje ka mbërritur Avokati i Popullit.

Fatjona Memçaj ndërhyr duke sqaruar se ndodhet përpara një pengese ligjore papajtueshmërie, të parashikuar nga neni 222-224 i ligjit nr.115/2016 për sa i përket pjesëmarrjes në veprimtarinë e Këshillit për procedurën e verifikimit të kandidaturave për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019, pasi një ndër aplikuesit është motra e bashkëshortit. “Gjej me vend që ta riparaqesë këtë kërkesë, pra që të më lejohet heqja dorë, sipas kërkesës që do të depozitoj me shkrim në sekretari. Gjithashtu, për sa i përket rendit të ditës, meqenëse unë nuk kam mundësi të jem pjesë e veprimtarisë së Këshillit që lidhet pikërisht për procedurën e verifikimit të kandidatëve për këtë listë, do të sugjeroja që relacionet e para t’i përkasin listës së kandidaturave të cilat janë sjellë nga Presidenti i Republikës pas rishpalljes së datës 27.09.2019. Nuk e di nëse kolegët bien dakord, kjo edhe për efekt që të mos këtë kontestime në një moment të dytë nga kandidatët që unë kam marrë pjesë në dëgjimin e relatiemeve për listat përkatëse, ku unë nuk duhet të marrja pjesë.”.

Vitore Tusha sqaron se renditja e kandidatëve në procedurën e shqyrtimit të gjetjeve sipas rendit të ditës, i është referuar listës së vakancave. Ajo shprehet se ka qenë në dijeni të faktit që nga viti i shkuar, sepse në të njëjtën situatë dhe të njëjtat fakte ligjore është arsyetuar për lidhjet e afërta që anëtarja zonja Memçaj ka me kandidaten Ardita dhe deklaroi që e pranon kërkesën për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj kandidature, pasi e vlerëson të bazuar, ndërsa motivimin e vendimit do ta paraqesë me shkrim. Ndërkohë lidhur me kërkesën për të filluar me vlerësimin e kandidatëve sipas vakancave, ato janë renditur sipas shortit që është zhvilluar, mund të ndiqet radha që është bërë, mund të ndiqet radha sipas alfabeti ose mund të ndiqet radha sipas subjekteve ose autoriteteve që i kanë dërguar, në funksion të shmangies së konfliktit të interesit.

Anëtarët shprehen se janë dakord për të filluar shqyrtimin e gjetjeve sipas listës së vakancës për të cilën është relatore zonja Arta Marku.

Saida Dollani merr fjalën duke propozuar: “Bie shumë dakord me çfarë u tha, duke qenë se ka kandidatë të përbashkët për të dyja relatorët, për zonjën Marku dhe për mua, them që atje ku zonja Marku do të relatojë, meqenëse ramë dakord që do të relatojë e para, për shkak të asaj që u parashtrua, unë të ndërhyj për të thënë që janë të njëjtat gjetje, që të mos këtë përplasje”.

Miranda Andoni shton diçka për procedurë. “Në qoftë se zonja Memçaj ka paraqitur kërkesë për dorëheqje për kandidaturën për vakancën e parë sipas renditjes së shortit që shoh, i përket Saidës, atëherë gjatë relatimit të zonjës Arta nuk mund të thotë Saida që unë jam dakord me këto gjetje, sepse Fatjona do të jetë prezentë dhe në një farë mënyre do të marrë dijeni për gjetjet e kandidaturës tjetër, tani ose të përjashtohet, jep dorëheqjen dhe nuk duhet të marrë pjesë në këtë shqyrtimin e kësaj kandidatures... Të jetë mendimi i relatores nuk duhet të shprehet.”

Vitore Tusha sqaron se rendin e ditës e ka përcaktuar duke u bazuar në kandidatët e të dy vakancave. Dosjet janë të veçuara sipas kandidatëve dhe i tillë do të bëhet relatimi. Anëtarja e dorëhequr nuk merr pjesë vetëm në çështjet që ka konflikt interesi.

Erinda Ballanca sqaron se vetëm relatimi do të jetë, vendimmarrja do të jetë tjetër, mund të jetë znj. Memçaj , për efekt procedural.

Vitore Tusha vë në dukje se “relacionet u janë përcjellë anëtarëve, të ftuarve, të gjithë atyre që përcakton rregulli i mbledhjes. Mund të ketë elemente shtesë, mund të ketë pyetje, sqarime, paqartësi. Po ashtu, ju bëj me dije se të gjitha aktet e KED-së të ndryshuara dhe të miratuara në mbledhjen e kaluar janë publikuar në Fletoren Zyrtare ditën e hënë, pra procedura ka përfunduar”.

Vazhdohet me rendin e ditës sipas listës së vakacës, për të cilën është relatore zonja Marku.

Arta Marku parashtron relatin për kandidatin Prel Martini për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, i rishpallur nga Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Miranda Andoni pyet: Eshte pasqyruar në relacion dorëheqja tjetër?

Arta Marku përgjigjet që është e njëjta, që kishte parë datën, *e-mailin*.

Miranda Andoni thotë se është njohur dhe kjo është dorëheqje e datës 08.11.2019.

Gjithashtu pyetet Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, nëse ka komente, meqenëse sipas procedurës jep një mendim lidhur me procedurën e ndjekur.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Kishte të bënte me këtë fakt nëse kjo dorëheqje ka qenë që në nëntor të vitit 2019, pse ne nuk kemi dalë më parë gjatë KED-së të mëparshme me një vendim për heqjen e këtij kandidati nga kandidimi se kjo ka qenë edhe procedura e ndjekur më parë. Kjo është një nga gjërat që duhet të evidentohet. Së dyti, sigurisht që nuk ka qenë përgjegjësi e juaja, zonja Marku, ju nuk keni qenë atëherë relatore e dosjes, por për efekt të ecurisë do të doja që ta arsyetoja. Unë nuk kam një koment sa i përket relacionit, po një pyetje për sa i përket relacionit në lidhje me momentin në të cilin këto relacione janë bërë me dijani, janë përgatitur, kanë përfunduar. Kjo ka të bëjë më tepër me faktin e çështjeve procedurale, me afatin që ka gjithsecili relator. Në përfundim, do të kërkoja, do të sugjeroja që të shënohet në relacione e dhëna se kur relatorja ia ka dërguar kryetarit materialin dhe kërkesën për të

organizuar mbledhjen, sepse edhe kjo e është një pjesë procedurale, se ka të bëjë me procedurën dhe me rregullat tona të verifikimit. Së dyti, që është gjithashtu shumë rëndësishme, që na ka dalë problematikë nga viti i kaluar, është momenti kur i është dërguar kandidatit dhe ta shënojmë në relacion, të kujdesemi që një kopje e këtij njoftimi të jetë në dosje. E them këtë nga viti i kaluar, e kam për kolegët, për anëtarët e rinj, me falni nëse ju them kolegë, nuk jam gjyqtare, nuk e kam këtë kënaqësi, por duke dashur të them juristë. Vitin e kaluar ne kemi pasur vendime të ankimueshme. Kemi pasur disa probleme, disa çështje që janë ankimuar dhe një pjesë e kandidatëve kanë pretenduar se nuk janë njoftuar në lidhje me aktin përfundimtar dhe për këtë arsye do të ishte mirë që ne të bënim këtë lloj verifikimi paraprak edhe vet të mos mbeteshim vetëm në atë që kanë përgatitur relatorët apo persona të cilët e kanë dërguar aktin e relacionit. Është e rëndësishme që ta shënojmë kur është dërguar dhe të themi që një kopje e komunikimit është në dosjen e kandidatit. Pse e them të dytën, sepse pas verifikimeve që kemi bërë si institucioni i Avokatit të Popullit për dosjet në kuadër të bërjes së raportit vjetor për KED-në, kemi verifikuar që këto akte nuk janë në dosje, nuk janë në dosjet e vjetshme, nuk janë fare. Kjo më tepër është për të përmirësuar punën te një detaj, i cili u gjet si një “problem” gjatë kohës së shkuar. Pra, duhet të ishte me rëndësi që edhe data në të cilën janë bërë këto komunikimi të shënohet, të jetë shënuar gjithandej. Këto ishin ato që unë kisha, për ndryshe vullneti është i shprehur i zotit Martini, nuk kemi asnjë problem”.

Arta Marku falënderon zonjën Ballanca për konstatimet: “Për sa i përket konstatimit të parë që dorëheqja është bërë në datën 08.11.2019, nuk mund t’i përgjigjem, sepse vetëm pas datës 15.01.2020 jam bërë relatore për këtë vakancë dhe për këtë kandidaturë. Për sa i përket mungesës së datës kur është njoftuar kryetari, relacionet kanë qenë gati në fakt që në fillim të marsit, është menduar për t’u përgatitur thirrja e mbledhjes dhe pastaj ndodhi ajo që ndodhi me situatën prej pandemisë dhe u pezullua gjithandej aktiviteti, përfshirë edhe institucionin e KED-së, prandaj dhe nuk është parë e rëndësishme të shënohet si datë. Për sa i përket njoftimit, njoftimet janë bërë nëpërmjet *e-mailit*. I printojmë, i vëmë në dosje dhe konstatimi juaj është i drejtë”.

Vitore Tusha fton relatoren në shqyrtimin e kandidaturës tjetër.

Arta Marku relatton për kandidatin Vasil Bendo për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, i rishpallur nga Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019.

Arjan Qafa ndërhyr duke sqaruar se ka trajtuar çështje në proces gjyqësor të zotit Bendo, konkretisht një ankim ndaj vendimmarrjes së KED-së së vitit 2019 dhe kanë qenë dy vendimmarrje, në një është shpallur moskompetenca, kurse të tjetra detyrimi për të vijuar procedurën: “Shpallja e moskompetencës ka qenë e lidhur me afatin dhe ne kemi thënë është kompetente gjykata e shkallës së parë për të trajtuar dhe ne nuk e dimë nëse ky vendim është shpallur, ka marrë formë të prerë. Për sa i përket pjesës tjetër, kemi disponuar për procedurën e verifikimit të kandidatit, mbase është ky rasti. Kërkesa për shfuqizimin e vendimi nr. 36, datë

14.05.2019 të KED-së është rrëzuar, duke ia dërguar gjykatës administrative të shkallës së parë për rivendosjen në afat.

Bledar Dervishaj e merr fjalën duke kujtuar se, përveç objektit të padisë shfuqizimin e vendimeve të KED padia e shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Administrativ në vitin e kaluar (2019) mesa më kujtohet ka patur si objekt edhe “rivendosjen në afat për dorëzimin e deklaratës së pasurisë. Sekretaria këtu në KED mund të nxjerrë vendimin e apelit dhe anëtarët e KED mund të njihen me përmbajtjen e këtij vendimi.

Erinda Ballanca sqaron se nuk është për shkak të njëjtë ka bërë kërkesë të re.

Ajo thotë se është kërkesë e re e Vasil Bendo dhe nuk është e njëjta procedurë, ku ka dhënë qoftë dhe një vendim të ndërmjetëm zoti Qafa.

Anëtarët diskutuan dhe u shprehën se vendimi i ndalimit të KED-së i vitit 2019 është ai me nr.36/2019 dhe vakanca ka të bëjë me vakancën për gjyqtar të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018 dhe se vakanca nuk është e njëjtë dhe gjykimi nuk ka qenë një shqyrtim themeli.

Çështja në të cilën ka marrë pjesë zoti Qafa ka qenë shqyrtimi i vendimit të KED-së, me të cilin ishte vendosur ndalimi i kandidimit të zotit Bendo, për shkak të mosdepozitimit të dokumenteve sipas afateve ligjore, pa u shqyrtuar themeli i çështjes.

Anëtarët vlerësuan se nuk ndodhemi përpara një rasti papajtueshmërie.

Arta Marku relaton për kandidatin **Vasil Bendo** për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, i rishpallur nga Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Miranda Andoni pyet: “A duhet të shprehemi në relacion, sepse sipas konkluzioneve të ILDKPI-së përfundimet janë:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka mosdeklarim të pasurisë.

1. A duhet të shprehim cila është pasuria që nuk është deklaruar?
2. Duhet të shpreheshim cilat janë dokumentet shtesë, në përgjigjen që ka dhënë kandidati? Kishte nevojë, nëse nuk janë të plota, ose kishte nevojë për dokumente shtesë për të gjitha shpjegimet e dhëna! Apo mjafton që ja u komunikojmë relacionin dhe tjetër
3. A ka nevojë për ekspertim? Për të konkluduar nëse këto burime financiare janë të ligjshme ose justifikojnë pasurinë ose jo?”

Arta Marku thotë se “në rastin kur relatori e çmon se ka nevojë për ekspertim bëhet objekt diskutimi dhe merret një vendim. Përderisa unë nuk e kam kërkuar, kam menduar që nuk

është e nevojshme, sepse problemet me pasurinë ishin, nuk ishim më çështje vlerash ishin mosdeklarim, mungesë burimesh financiare, mosdeklarim i pasurisë. Unë e kam menduar që nuk është e domosdoshme, sepse konkluzionet janë këto. Argumentet që janë dhënë dhe dokumentet që janë paraqitur, ju i dëgjuat dhe nëse ju mendoni se këto ndikojnë në raportin e ILDKPI-së, këtu e diskutojmë”.

Fatjona Memçaj thotë se relatori parashtron mbi gjithë gjetjet e procedurës. Në fund të relacionit ose në mes të procedurës. Kemi procedurë që është bërë objekt diskutimi nevoja për caktimin e një eksperti edhe pasi ka përfunduar relacioni dhe relatori e përfundon, asnjë nga anëtarët nuk pengohet që të bëjë një kërkim të tillë.

Saida Dollani mendon se nuk ka nevojë për shtesa. Po të lexohet neni 236, si dhe nenet 235, 235-236 që kanë të bëjnë me pasurinë dhe me figurën, thelbësisht i referohen ILDKPI-së apo figurës që e shikon atë.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Përveç komenteve të cilat unë i bëra për rastin e Prel Martinit dhe janë të vlefshme për secilin prej rasteve, do të konsideroja që në këto relacione të ketë një përmbledhje ashtu siç kishte, domethënë janë konkluzionet e gjetjeve të ILDKPI-së, se ato janë të sakta, por ama cilat kanë qenë faktet që e kanë çuar ILDKPI-në në këtë vendimmarrje, do të duheshin, në gjykimin tim, të ishin përmbledhtazi të përcaktuara në relacion. Pse? Kjo për faktin se vetë Këshilli, e ka, dhe në vitin e kaluar, dhe në rregulloret që ka bërë i ka njohur vetes të drejtën që të rishikojë qëndrimin e mbajtur nga ILDKPI-ja. Pra, Këshilli, qoftë për faktin që në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkonte vetë informacion të mëtejshëm përveç ILDKPI-së, pra, ne bëjmë një hetim dhe vetë Këshilli ka vendosur të bëjë një hetim të mirëfilltë për kandidatët, ka pasur një tendencë që ne, dhe unë kam qenë dakord, duke qenë se mbroj interesat të themi edhe të publikut, që për sa kohë që nuk ka një procedurë administrative për këtë rast në ILDKPI dhe nuk ka asnjë mundësi tjetër verifikimi dosjesh dhe ballafaqimi të së drejtës së kandidatëve për të kundërshtuar gjetjet e ILDKPI-së, do ta them më tej pse është ky fakt, kemi thënë që kandidatët të kenë të drejtë të mbrohen dhe të kenë mundësi të paraqesin prova shkresore, por ama ky Këshill do të vendosë, gjykoj unë, duke i trajtuar një nga një të gjitha gjetjet. Prandaj, unë jam shumë dakord me qëndrimin e zonjës Miranda, e cila thotë që do të duhet të kishim një sqarim të fakteve, të rrethanave, të faktit konkret, i cili ka përbërë apo nuk ka përbërë shkak për ILDKPI-në për të arritur në atë relacion, si dhe një prezantim të këtyre fakteve për të gjithë anëtarët e Këshillit. Unë jam e bindur që anëtarët i kanë parë dosjet, por nuk është kaq e thjeshtë që të shkosh në deklaratimet e ILDKPI-së, një pas një edhe në deklaratat e tyre, por mendoj se kandidatëve në parim duhet t’u japim mundësi edhe për faktin se ka një mungesë hetimi administrativ në ILDKPI. ILDKPI-ja nuk pranon dokumente shtesë. Ka një procedurë të ndryshme nga procedura që ka për deklaratimet periodike. Nuk pranon dokumente shtesë, ka vetëm ato, nuk pranon hetim administrativ, kjo ka qenë edhe një nga gjetjet që dhe vetë në raportin e vetë KED-ja ka bërë dhe ne si Avokat Populli kemi bërë dhe ja kemi dërguar Kuvendit

ku kemi thënë që duhet të garantohet, duhet të rregullohet kjo procedurë. Sepse kushdo ka të drejtë një çështje që ILDKPI-ja mund ta ketë trajtuar në një mënyrë të caktuar, ka të drejtë të mbrohet. Të japë argumentet e veta dhe të ketë qoftë administrativisht, qoftë në Këshill dhe ka pasur një qëndrim në lidhje me faktin nëse ne mund të marrim apo nuk mund të marrim ekspert. Këshilli mund të marrë apo nuk mund të marrë ekspert, është e vërtetë ajo që tha zonja Marku që kjo është së pari në vlerësimin e relatorit, por edhe nëse relatori nuk e gjykon për mendimin e tij kjo gjë është e mjaftueshme të jetë, është e qartë për të, gjithsesi prapë Këshilli ka mundësin të bëj një gjë të tillë, të vazhdoj më tej, të thelloj më tej hetimi gjithmonë duke ju dhënë gjithmonë mundësia kandidatëve për tu shprehur pastaj në lidhje me ekspertin apo me gjetjet e ekspertit. Prandaj, mendoj se në lidhje me këtë aspekt relacioni duhet të përmbajë disa të dhëna më konkrete për t'ia bërë të mundur. Pse e themi këtë? Për ta bërë të mundur që të ketë vlerësimin e gjetjeve të veta, verifikimin dhe vlerësimin e bërë nga vete relatori që është kërkesa e ligjit. Ku thuhet; në relacion përmbahet vlerësimi, ka një vlerësim. Këtu nuk shohim në asnjë vend asnjë vlerësim nëse në këto gjetje janë apo nuk janë të tilla që të çojnë në një vendimmarrje apo në një vendimmarrje tjetër. E dimë qëndrimin që ka mbajtur Këshilli vjet, që nuk duan të japin mendim sepse mendohet për paragjykim. E dimë! Ne si Avokat Populli kemi një qëndrim tjetër në lidhje me këtë çështje dhe prandaj sipas kërkesave të ligjit, ose kështu neve e lexojmë, prandaj më duhet që ta them.”.

Vitore Tusha sqaron se ky është një debat i bërë mbi çdo kandidaturë që është shqyrtuar nga KDE-ja. Relacioni ka një format për të cilin është rënë dakord, por mund të përmirësohet me elemente të caktuara, si p.sh. data në të cilën është komunikuar ky relacion kandidatit, Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë, si dhe data kur relatori informon kryetarin për përgatitjen e relacionit.

Anëtarët diskutuan për formatin e relacionit dhe deri në çfarë mase relacioni duhet të përmbajë analizën ligjore dhe faktike mbi gjetjet. Ai duhet të përmbajë të gjithë hetimin e kryer dhe gjetjet përkatëse, të cilat do t'i shërbejnë vendimmarrjes.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe citon në parim se: “Ne që përfaqësojmë organet e emërtesës sipas rregullit, në momentin që Këshilli hyn në diskutimin e gjetjeve për kandidatët, nuk na lejohet të japim mendim rreth tyre. Por duhet evidentuar se, janë të drejta shqetësimet e anëtarëve të KED, të zotit Ludovik, relatores tjetër zonjës Andoni, të zonjës Papajorgji dhe të prokurores. Duke qenë të njohur me faktet që deri më sot subjektet konkurrentë, nuk e lënë pa konsumuar mundësinë e kundërshtimit të akteve të KED në rrugë gjyqësore, aktet e KED duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë shteruese. Sepse është krijuar tashmë një traditë që vendimet e KED kundërshtohen në rrugë gjyqësore dhe mund të ndodhë që, Këshilli të ndeshet me shumëllojshmëri pretendimesh, hipotetikusht psh, shfuqizohet vendimi i Këshillit dhe çështja kthehet mbrapsht për komponentin e pasurisë. Me pas, Këshilli do të rishqyrtojë dosjen dhe do të shprehet edhe për vjetërsinë ?!.

Arta Marku vijon relatimin në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera përveç atij të pasurisë për kandidatin Vasil Bendo.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje.

Anëtarët nuk kanë pyetje.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Në vijim të relatimit që bëri zonja Marku, duke e falënderuar, mu kujtua një çështje që e kam ngritur edhe vitet e mëparshme, që ka të bëjë me verifikimin e anëtarësimit apo të qenit në organe drejtuese të partive politike. Vjet kemi pasur një problematikë, pasi nuk gjendeshin vendet e partive dhe kërkesat ishin vetëm për partitë kryesore. Dua t’ia parashtroj edhe anëtarëve të tjerë të Këshillit, çka do të thotë se në momentin aktual që flasim duhet të jemi koshientë se për një numër të madh partish ne nuk kemi informacion, sepse nuk janë adresat, nuk janë listat dhe në këtë rast nga dokumentet që na kanë ardhur ne nuk i jemi drejtuar më as KQZ-së për t’i kërkuar informacion nëse ka qenë kandidat në zgjedhje”.

Vitore Tusha sqaron se i drejtuar të gjitha partive, adresat e të cilave janë të sakta.

Erinda Ballanca sqaron: “Shqetësimi që kemi pasur ne si institucion dhe që e bëmë më pas publik, ka qenë sepse është anatemuar Avokati i Popullit për shkak se pretendojnë, pavarësisht se ka të drejtë nuk kishin verifikuar nëse x apo y person ishte në vetting kishte qenë apo jo anëtar apo kandidat për një parti politike, që ka qenë lëvizja “Mjaft” apo “G 99” dhe më pas e mori atë si detyrë. E them këtë, sepse nuk i vlerësojmë me sensin për ta bërë punën më së miri, kur ka kundërshtime të të tjerëve, kur bëjmë një hetim të së kaluarës dalin këto probleme”.

Vitore Tusha shprehet se është dakord me sugjerimin.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Mund të vendosim që një kriter të caktuar ta plotësojmë nëpërmjet vetëdeklarimit, n.q.s. ne kemi vetëdeklarimin që ai nuk ka qenë anëtar i asnjë partie politike, KED-ja si institucion të ketë të realizuar nëpërmjet vetëdeklarimit një të dhënë që ai nuk e merr dot, d.m.th. nuk ka mundësi që ta verifikojë një të dhënë, të paktën të jetë në kushtet e vetëdeklarimit një x apo y kriter”.

Fatjona Memcaj sqaron se te kushtet e vetëdeklarimit, duke qenë se nuk ka një rezervë ligjore, nuk ka pasojë n.q.s. nuk thotë të vërtetën. Ai duhet të ketë pasojë për ato që bën.

Erinda Ballanca vë në dukje se “ka pasur një rast, e kam parasysh për çfarë flisni, por ajo që unë them është që të paktën ne kemi bërë detyrën tonë, KED-ja ka bërë detyrën e vet, nuk ka pasur mundësi për këto shkaqe që po evidentohen se, pse kjo është e vërtetë, nuk ka mundësi reale, se realisht puna që është bërë, letrat që dërgohen, informacioni që kërkohet, relacionet, tregon që vërtet Këshilli ka pasur maksimalisht vullnetin për ta bërë punën siç duhet. Por edhe në kushtet e pamundësisë, të paktën të marrim atë informacion që mundet për kandidatin, pastaj kandidatit i ngelet gjithmonë përgjegjësia për sa i përket figurës, reputacionit. Sot e tutje do të

jetë ndryshe besoj unë standardi i zbatimit të ligjit dhe standardi i qëndrimit ndaj detyrës për veprime apo mosveprim, e të cilat e cenojnë qoftë reputacionin, qoftë figurën e tij”.

Arta Marku relatton për kandidaten Vjosa Bodo Mujo, e cila është candidate për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët nuk kanë pyetje ose sqarime.

Erinda Ballanca pyet: “Në lidhje me pretendimin e zonjës Bodo, se ajo ka qenë për një periudhë kohe e atashuar pranë studios ligjore të zonjës Zana Hasko, a ka ndonjë, përveç se ka marrë provimin e avokatisë dhe licencën, dokument tjetër, i cili të vërtetojë në një mënyrë apo tjetër pagesën e saj gjatë kësaj periudhe, pra deri në vitin 2001 pranë kësaj studioje dhe nëse ka ndonjë dokument tjetër që vërteton që licenca e saj ka qenë e ripërtërirë vit pas viti, pra ka qenë licence aktive, gjithmonë për ta ndihmuar për efekt të vërtetimit të vjetërsisë, jo për ta penalizuar?”.

Arta Marku sqaron se ajo nuk e ka pretenduar se ka ushtruar profesionin e avokatit, e ka marrë licencën, por nuk e ka ushtruar si detyrë. E ka marrë si titull, por nuk ka qenë asnjë ditë avokate të paktën sipas deklarimeve të saj nuk pretendon të ketë ushtruar këtë detyrë.

Erinda Ballanca merr fjalën “Prandaj them, ne na duhet titulli apo ushtrimi në profesion. Për sa lexova unë në relacion keni relatuar në mënyrë të vërtetë atë që ajo ka thënë. Pretendimi i saj është që, unë për efekt vjetërsie e konsideroj të plotësuar se kam një licence avokatie. Tani ligji, se këtu është një problem tjetër, si e ka interpretuar këshilli gjatë viteve të kaluar, ka pasur për qëllim, do të thotë ushtrim të detyrave shtetërore të tilla, vetëm të drejtë për të ushtruar detyra të tilla sepse për ndryshe i binte që çdo jurist mund të kishte potencialisht të drejtën për të ushtruar funksione të larta në instancat shtetërore. Unë kisha shpresuar që të kishte një licencë të vlefshme ku të paktën ta kishte ushtruar.

Ajo vë në dukje se ju mbetet qëndrimeve të saja. Plotësimet që ka bërë do t’i çojë dhe me shkrim që të kihet parasysh për çështjet e datave, kur i është komunikuar palës, kur i është komunikuar Këshillit dhe kur i është komunikuar kryetarit.

Informacionet me shkrim dot’ i vërë në dispozicion të Këshillit për t’i pasur parasysh. “Kisha dhe një sugjerim tjetër, po ta mendoni të vlefshëm mund ta merrni parasysh, duke qenë se këto në relacion, Këshilli e di, anëtarët e dinë për çfarë arsye është bërë pezullimi i kësaj procedure, d.m.th. kjo është e qartë për këdo që ka qenë, ndërsa për të tjerët që janë të jashtëm, ndoshta nuk kuptohet pse është marrë vendimi i pezullimit për këtë vakancë. T’u themi qartë që vendimi është marrë për shkak të numrit të rënies së candidateve, është qartësi, nuk është sa ka ndonjë thelb të rëndësishëm”.

Arta Marku vijon me relacionin për kandidaturën e zoti Besnik Muçi, ku ka kandiduar për të plotësuar vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme pas mbarimit të parakohshëm të gjyqtarit Besnik Imeraj.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët nuk kanë kërkesa, pyetje ose sqarime.

Erinda Ballanca nuk ka pyetje dhe as komente.

Arta Marku relatton për kandidatin Shaqir Hasanaj, , ku ka kandiduar për të plotësuar vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme pas mbarimit të parakohshëm të gjyqtarit Besnik Imeraj.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Ludovik Dodaj pyet nëse masat përfshihen tek vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Arta Marku përgjigjet: Nuk janë të përfshira të dyja, ndërkohë vërejtja me paralajmërim është parashkruar.

Erinda Ballanca ka një pyetje: “Në disa prej relacioneve, në verifikimet që ne kemi kryer, ka pasur një bankë që nuk ka kthyer asnjëherë përgjigje e cila është ALPHA Bankë. Ndoshta duhet që ta adresojmë që në fazën e dytë ta kuptojmë këtë gjë dhe të themi se nuk ka kthyer asnjëherë përgjigje, por nuk ka të dhëna të rëndësishme? Nga përputhja e deklaratave tona me ILDKPI-në, në ILDKPI ka kthyer përgjigje dhe atje s’ka pasur, ka qenë zero kjo gjë, të mos na dalë nesër pasnesër në relacion apo me mendim si një gjë që... që të mos themi më vonë... këto nuk e kanë bërë mirë punën, s’ka kthyer përgjigje ai dhe këto kanë vazhduar punën. Gjithsesi, ne vërtet nuk na ka kthyer përgjigje, por rezulton se ka kthyer përgjigje në ILDKPI, dhe rezulton se nuk ka asnjë lloj të dhëne për të ndryshuar pozicionin procedural dhe në gjykimin se nuk është e nevojshme ta ribëjmë kërkesën apo ta rivlerësojmë, e konsiderojmë të përmbushur, pra mund të ishte një si zgjidhje, si gjetje që e kisha menduar në lidhje me këtë çështje”.

ILDKPI-ja ka kërkuar informacion dhe e ka marrë nga ALPHA Bankë. Për këtë arsye e gjen si zgjidhje. Zonja Ballanca ka dhe një pyetje tjetër: “Ka të bëjë me faktin e vendimeve gjyqësore të cilat ai i ka paraqitur. Pra, unë e kem lexuar dhe argumentimin e tij dhe ai nuk është shumë i qartë për të sqaruar nëse vendimi konkret të Gjykatës Kushtetuese kanë qenë 2 vendime që kanë pasur për objekt bazën ligjore mbi të cilën është larguar nga detyra, është pyetja ime apo kanë qenë vendime të cilat kanë qenë, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me një procedure të tillë të bërë prej tij kundër vendimit të shkarkimit?”.

Vitore Tusha sqaron se në të dyja vendimet e Gjykatës Kushtetuese është kryer kontroll abstrakt.

Arta Marku parashtron relatimin për kandidatin Dedë Kasnecin për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur dhe rishpallur nga Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët nuk kanë kërkesa, pyetje, sqarime.

Erinda Ballanca nuk ka pyetje dhe as komente.

Arta Marku vazhdon me relatimin për kandidaturën e zotit Envi Hicka. Edhe për këtë kandidat është bërë verifikimi i plotë i kushteve dhe kritereve, por ky kandidat ka njoftuar Këshillin, ditën e mbledhjes, se jep dorëheqjen për kandidimin në pozicionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Vitore Tusha sqaron se kërkesa për dorëheqje e këtij kandidati i është shpërndarë të gjithëve anëtarëve. Ndërkohë sugjeron të vijohet me relatimin e procedurës së ndjekur sipas relacionit dhe më pas të shqyrtohet kërkesa e dorëheqjes.

Arta Marku relaton për kandidatin Envi Hicka për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, i rishpallur nga Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019 dhe vë në dukje se kërkesa për dorëheqje është motivuar me faktin që Këshilli, pas komunikimit të relacionit, duhet t'i drejtohej ILDKPI-së që të sillte dokumentacion mbi bazën e të cilit u arrit në këto konkluzione

Vitore Tusha pyetet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët diskutuan rreth pretendimeve të paraqitura nga kandidati si shkak i dorëheqjes dhe lidhjen e tyre me vullnetin për t'u tërhequr nga konkurrimi. Ata shprehen qëndrimin se hetimi administrativ i kryer nga KED-ja është i plotë, dhe se pretendimet e kandidatit për marrjen e dokumentacionit nga ILDKPI-ja kanë të bëjnë me subjektin e lidhur me kandidatin dhe që njëkohësisht është dhe subjekt i rivlerësimit kalimtar.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Ka një qëndrim të datës 14, por pyetja ime është: Cili ka qenë qëndrimi i zotit Hicka kur ka marrë gjetjen e ILDKPI-së, se ILDKPI-ja nuk e ka sjellë tani, i ka sjellë që në korrik, pra janë të një periudhë të mëparshme? Në gjykimin tim që nga data që ai ka marrë gjetjet e ILDKPI-së dhe deri në datën e sotme ka pasur një kohë të mjaftueshme për të paraqitur prova, dokumente shtesë, gjithçka që ai kishte ose kërkonte të hetonte për t'i mbushur mendjen Këshillit që nuk ishte në kushtet apo që nuk ishin gjetjet e ILDKPI-së gjetje korrekte. Është barra e provës e tij në gjykimin tim që të vendoste përpara Këshillit në një kohë kaq të gjatë që nga nëntori i vitit të kaluar dhe deri tani. Nuk u vu në dijeni për këto lloj gjetjesh tani në momentin që ne i dhamë relacionin. Kjo është e vetmja gjë të mos shkoj sipas logjikës së znj. Memçaj. Pra, nuk ishte hera e parë dhe nuk ishin gjetje të reja dhe ia vumë me dijeni përpara pak ditësh dhe ai nuk kishte më asnjë mundësi tjetër dhe na kërkoi ne për të bërë veprime procedurale. Nga ana tjetër, unë nuk mendoj se zotëria ka dhënë dorëheqjen e kushtëzuar, ai ka dhënë dorëheqjen duke fajësuar KED-në dhe kjo është një gjë tjetër. Nuk është e kushtëzuar për

mendimin tim. Ai nuk thotë që unë nuk do ta kisha dhënë dorëheqjen nëse për këto arsye për mua secili gjithmonë mund të gjejë një shkak që është i lirë ta mendoj shkakun për të cilin jep arsyen. Unë mendoj se Këshilli nuk ka pasur asnjë lloj keqdashje apo as një lloj veprimi të posaçëm negativ ndaj tij që ta bëhet dhe të ishte duke e vlerësuar rastin me objektivitet siç dhe ka bërë dhe në raste të tjera deri më tani dhe unë jam pro e këtij fakti sa i përket procedurës së verifikimit që unë kam marrë pjesë”.

Arta Marku e merr fjalën: “Në vijim të asaj që tha zonja Ballanca, gjetjet e ILDKP-së i janë bërë prezente kandidatit Envi Hicka nga Këshilli në mënyrë elektronike në datën 10.12.2019 dhe i është kërkuar të paraqesë shpjegime dhe çfarëdolloj dokumentacioni justifikues. Ai ka dhënë shpjegimet me shkresën e datës 31.12.2019 nr. 827 prot. qoftë me emalin e datës 30.12.2019. Shpjegimi është i detajuar dhe është pasqyruar i plot në relacion nga faqja 5 deri në faqen 11, kështu që është në dijeni prej kohësh me rezultatet e ILDKP-së”.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Pyetja ime është që atëherë na ka kërkuar që ne t'i mbledhim dokumentet dhe ne nuk kemi vepruar? Kjo përbën dhe diferencën.”

Bledar Dervishaj e merr fjalën për procedurë: “Jashtë relatiemeve që bëri relatorja për 7 kandidatët e kësaj vakance që i takon Presidentit të Republikës, ngelet pa relatuar nga gjithë kandidatët edhe për kandidaten tjetër zonjën Regleta Panajoti. Kjo kanidate ka një vendim lejimi të Këshillit të vitit 2019. Më pas, sic mund të kujtohet numri i kanidatëve ra për këtë vakancë ra nën numrin 3, çështja u pezullua në KED dhe kjo vakancë u rishpall për aplikim. Këshilli është e sigurt që do të ndeshet me nevojën e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe të akteve nënligjore që u miratuan në mbledhjen e kaluar, sa i takon momentin kur KED është para rastit që kandidati ka marrë një vendim kualifikimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pozitiv, dhe çështja ka shkuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. E vetmja pyetje në këtë rast është: pasi hynë në fuqi ndryshimet në aktet nënligjore të Këshillit, a ka ndonjë komunikim me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit për gjëndjen e procedimit të kësaj kanidate, përveç faktit të bërë publik në media që kandidati ka dhënë dorëheqjen”?

Saida Dollani ndërhyr: “Zoti Bledar, relatimin tim do ta filloj pikërisht me prezantimin e arsyeve pse nuk është përfshirë në rendin e ditës relatiimi rreth gjetjeve të zonjës Regleta”.

Vitore Tusha sugjeron të vijohet me kandidaturat e tjera, ku relatores është zonja Dollani.

Saida Dollani paraprakisht sqaron: “Duke qenë se me disponim kam parashikuar për dërgimet e relacioneve dhe të projektakteve në Këshill, po në këtë mënyrë kam disponuar për mosdërgim e relacionit dhe projektaktit për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit për zonjën Regleta (lexon të plotë disponimin e saj për arsyet e mosdërgimit të relacionin dhe projektaktit në shqyrtim).

Vijojmë me relacionin e zotit Rado, Klodjan Rado. Zoti Klodjan Rado ka dhënë dorëheqjen. Tani është e vërtetë vërejtja që bëri Avokatja e Popullit që duke qenë që dorëheqja e zotit Rado ka qenë e mëparshme, mirëpo me thënë të drejtën duket nga datat e disponimit që në datën 15, në datën 15 janar është hedhur shorti në mos gaboj dhe ka munguar relatori, në datën

28 shkurt të gjitha relacionet kanë qenë për t'u dërguar kështu që maksimalisht. Atëherë nuk po i futem zbatimit, nuk po i lexoj se kur janë bërë vakancat pasi secili prej jush i ka përpara dhe është njohur me to, po ashtu jeni të njohur që unë jam relatorja e 3-të që kam marrë në shqyrtim, po juve i njihni të gjitha. Duhet thënë se zoti Rado, është tërhequr nga kandidimi”.

Saida Dollani vijon me relatimin për kandidatin Klodjan Rado, kandidat, për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse ka pyetje.

Anëtarët nuk kanë pyetje.

Avokati i Popullit nuk ka pyetje.

Saida Dollani relatton për kandidaten Vjosa Bodo Mujo, e cila është kandidate për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo. Është i njëjti relacion me atë të relatuar nga zonja Marku, janë të njëjtat gjetje. Zonja Dollani pyet nëse ka pyetje në lidhje me zonjën Vjosa Bodo.

Erinda Ballanca bënë të ditur se pyetjet janë sqaruar.

Saida Dollani relatton për kandidatin Shaqir Hasani, që është kandidat për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo. Relacioni është i njëjtë me relacionin që lexoi zonja Marku. Ajo theksoi se “disa paqartësi u ezauruan, nuk ka ndonjë gjetje tej asaj që thamë, që Gjykata Kushtetuese në fakt është iniciuar mbi kërkesën e dy personave të tjerë për heqjen e masës së shkarkimit nga detyra dhe jo në mënyrë eksplicite. Pra, masa gjendet e shënuar sipas gjithë të dhënave në regjistrin e Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe sipas shkresave të përcjell prej tyre”.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje.

Anëtarët nuk kanë pyetje.

Saida Dollani relatton për kandidatin Dedë Kasneci, i cili është kandidat për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo. Edhe për zotin Kasneci është i njëjti relacion që relatoi zonja Marku. Ajo evidenton që janë të njëjtat gjetje mbi pasurinë e tij.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje.

Anëtarët nuk kanë pyetje.

Erinda Ballanca pyet nëse është vetëm kjo gjetje. “S’bëtë gjetje tjetër të vjetërsisë?”

Saida Dollani pergjigjet se ka gjetje edhe për vjetërsinë, prandaj u theksua se është i njëjti relacion me atë të zonjës Marku, por u vlerësua që të shpjegoheshin më në hollësi gjetjet mbi pasuritë.

Vitore Tusha vë në dukje që anëtarja zonja Fatjona Memçaj largohet për të mos qenë pjesë në procedurën e kandidatës Ardita Alsula për shkak të pranimit të kërkesës së saj për të hequr dorë. Është rasti të theksohet se anëtari zëvendësues i Prokurorisë së Apelit i shortuar ka qenë prokurori, zoti Nezir Gjoka, i cili është tërhequr nga detyra, arsye kjo për të cilën nuk merr pjesë.

Saida Dollani fillon parashtrimin e relatimit për kandidaten Ardita Albuna Sula, që është kandidate për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje.

Anëtarët nuk kanë pyetje.

Erinda Ballanca falënderon zonjën Dollani për relacionin edhe për relatimin, i cili ishte mjaftueshëm i plotë. “Pyetja që kisha unë kishte të bënte me të dhënat ose gjetjet negative që kishte pasur ILDKPI-ja në lidhje me bursat e studimit të zonjës Buna. Thjesht është tërësisht rastësore, po në të njëjtin fakultet, pra në Fakultetin e Trentos kam studiuar dhe vet në vitin e tretë, pra viti i parë ka qenë një marrëveshje midis Fakultetit të Drejtësisë së Shqipërisë dhe Fakultetit të Trentos. Në vitin e parë ka qenë zonja Buna, Arsula Buna dhe shumë të tjerë Ledi Bjanku, etj., vitin e dytë dhe vitin e tretë, të fundit kam qenë dhe vetë. Dhe duke e menduar këtë gjë mbrapsht, çfarë të dhënash duhet të paraqiste? Unë çfarë të dhënash mund të gjej që më ka çuar Fakulteti i Drejtësisë i Shqipërisë me listë për të marrë një bursë studimi? Dhe vërtet jam duke e menduar që të ardhurat e saj apo... Pyetja ime është: çfarë mund t’i kenë kërkuar që duhet të plotësonte si dokumentacion? Të paktën për këtë ke thënë ke mungesë...”

Saida Dollani thotë: “Është zonja Buna që ka deklaruar se ka përfituar nga bursa disa të ardhura”.

Erinda Ballanca pyet nëse ka ndonjë investigim “Cili ka qenë informacioni që ajo mund të ketë paraqitur? Se ajo ka paraqitur atë informacion që ka. Për shembull, emërimi që ka qenë me bursë 100% nga Fakulteti, letrën nga Fakulteti që ajo ka vajtur atje, siç do ta kisha paraqitur edhe unë. Marrëveshjen financiare të Fakultetit me Fakultetin e Trentos unë nuk kam nga ta kem, mund të kem... Domethënë se jam duke menduar në të kundërtën. Është një informacion që s’kam nga ta kem se dhe atëherë nuk kisha nga ta kisha”.

Saida Dollani sqaron se e ka thënë zonja Buna. “Për sa i përket konkluzionit që dokumentacioni justifikues në lidhje me të ardhurat e krijuara nga bursa, punësimi etj. është jo e plotë, bashkëlidhur po ju dërgoj një dokument shtesë që kam siguruar gjatë këtyre ditëve, konkretisht një artikull historik nga IDAIK, Instituti për Unifikimin e së Drejtës Agrare të Krahasuar, ku përmendet emri i saj si bursiste dhe një vërtetim të lëshuar nga Universiteti i Shkodrës për të ardhurat nga punësimi për periudhën 93-96, ku këto të ardhura nuk kanë shërbyer si burim për të krijuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme.”.

Vitore Tusha propozon, përpara se të vazhdohet me shqyrtimin dhe vendimmarrjen, një pushim për arsye të kohës së domosdoshme për aparaturat e regjistrimit edhe për ajrosjen e ambientit. Në këtë procedurë për herë të parë merr pjesë Avokatja e Popullit, e cila do të na vëzhgojë të gjithë mënyrën e diskutimit, shqyrtimit, analizës, vendimmarrjes në funksion të transparencës sa më të madhe brenda kuadrit për të qenë të mbyllur.

Bledar Dervishaj e merr fjalën duke falënderuar Këshillin, “Në fakt mbledhjen e kaluar nuk e bëmë, por prisnim që të ndodhte pikërisht kjo që ju sapo deklaruat për zbatimin e rekomandimeve të drejtpërdrejta të Komisionit të Venecias me miratimin e akteve nënligjore, ndryshimin e tyre dhe hyrjen në fuqi. Ne e kemi thënë edhe herën e kaluar që ato rekomandime të Komisionit të Venecias janë dylojëshe, miratimi i ndryshimeve në aktet nënligjore të KED që u miratuan dhe veprimet administrative që vijnë natyrshëm nga zbatimi i këtyre akteve nënligjore. Në këtë moment po futemi në zbatimin e akteve nënligjore, ku atë që deri më tani konsiderohej si moment i mbyllur i Këshillit, tashmë në këtë fazë të diskutimit do të jetë pjesëmarrës edhe Avokati i Popullit për të vëzhguar këtë proces sesi edhe mund të ketë ndodhur përpara një viti ku proces diskutimi ndërmjet anëtarëve të këshillit. Kjo është për t’u përshëndetur (pjesëmarrja e avokatit të popullit në diskutimet ndërmjet anëtarëve të Këshillit).

Një çështje tjetër që unë do të doja ta vendosja në vëmendje të Këshillit: vërtet KED-ja duhet të fokusohet në diskutimin e të gjitha gjetjeve për secilin kandidat referuar përmbushjes së kërkesave të Kushtetutës dhe të ligjit për të qenë kandidat i vlefshëm për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, po ashtu duhet të ketë parasysh edhe frymën që përcjell Komisioni i Venecias për sa i takon nevojës jetike që ka vendi për të pasur një gjykatë kushtetuese funksionale sa më shpejt.

Në këtë moment mua nuk më ngelet asgjë vetëm t’ju uroj suksese në fazën e tretë të kësaj mbledhje dhe t’ju rikujtoj njëkohësisht edhe nevojën e vijimit të punës së pandërprerë prej KED për vakancën tjetër të Presidentit të Republikës që kërkon dhe ajo një shqyrtim dhe impenjim nga Këshilli me funksion të pandërprerë për shkak se është një vakancë në proces. Nisur nga informacioni që ju na dhatë herën e kaluar, ku dy subjekte, (banka), nuk kishin sjellë informacion më duhet të kujtoj që në të njëjtat nivele/kushte ndodhen dhe këto dy vakancat që kaluam. Kërkojmë impenjimin e relatorit dhe bashkë me të edhe të Këshillit që të ecim sa më shpejt për kandidaturat që i përkasin kësaj vakance. Ju urojmë punë të mbarë nga ana e Institucionit të Presidentit të Republikës edhe suksese!”

Vitore Tusha falënderon dhe mbyll mbledhjen!

Mbledhja mbyllet në orën 17:25

Tiranë, më 17.07.2020

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

Elona KARDHIQI

Fabjola MUHAMETI

Vilma DOKUSHI

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA